



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR

MANUAL UDHËZUES PËR CERTIFIKIMIN DHE RICERTIFIKIMIN E PUNONJËSVE TË
SIGURISË NË AVIACION

ACAA-DAS-GM1-CRP

Lëshimi: 02, Rishikimi 01

Date: 21.07.2026

Miratur nga:

Maksim Et'hemaj

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil





Qëllimisht lënë bosh

0 ADMINISTRIMI

Tabela e Përmbajtjes

0 ADMINISTRIMI.....	3
0.1 Regjistri i Rishikimeve	4
0.2 Lista e Miratimeve	4
0.3 Tabela e Rishikimit	5
0.4 Lista e Shpërndarjes.....	5
0.5 Përkufizime	6
0.6 Shkurtime	7
1. OBJEKTIVAT DHE ZBATUESHMËRIA.....	8
1.1 Qëllimi	8
1.2 Baza Ligjore	8
2. POLITIKAT DHE PROCEDURAT	8
3. TRAJNIMI	9
4. KËRKESAT PËR CERTIFIKIM TË PUNONJËSVE TË SIGURISË.....	9
4.1 Operator Skaneri	10
4.2 Supervizor Operator Skaneri.....	10
4.3 Ruajtje & Patrullë (G & P).....	11
4.4 Supervizor Ruajtje & Patrullë (G&P).....	11
4.5 Menaxher Sigurie (Operacional)	12
4.6 Menaxher Sigurie (Drejtues)	13
4.7 Instruktor i Sigurisë	14
5. KËRKESAT PËR RI-CERTIFIKIM TË PERSONELIT TË SIGURISË	16
6. VLERËSIMI	16

0.5 Përkufizime

Për qëllimin e këtij manuali udhëzues, termit e mëposhtëm nënkuptojnë:

Autoriteti përkatës: nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të përcaktuar për koordinimin dhe monitorimin e implementimit të Programit Kombëtar të Sigurisë të Aviacionit Civil.

Parimet e faktorit njeri: Parimet që aplikohen për të përgatitur, certifikuar, trajnuar, operimin dhe mirëmbajtjen, që kërkon ndërhyrje të sigurta ndërmjet elementit njeri dhe komponentëve të sistemit me anë të vlerësimeve përkatëse të veprimtarisë njerëzore.

Personeli që nuk merret me sigurinë: Do të nënkuptojë personelin që nuk është i përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e kontroleve të sigurisë së aviacionit civil (p.sh. personeli shitës, pastruesit e terminaleve dhe avionëve, personeli që ofron ushqimet, etj.), por që hyjnë të pashoqëruar në zonat e kufizuara të sigurisë së një aeroporti.

Personeli i sigurisë: Do të nënkuptojë personelin e përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e masave dhe kontroleve të sigurisë së aviacionit.

Operator Skaneri: Do të thotë çdo person që gëzon të drejtën të operojë në pajisjet me rreze X ose EDS siç përcaktohet në Certifikatën e lëshuar nga AAC.

Agjent Patrulle: Do të thotë çdo person që gëzon të drejtën për të patrulluar nëpër ambientet e aeroportit, ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror apo të kompanive ajrore siç përcaktohet në Certifikatën e lëshuar nga AAC.

Kontrolli i së kaluarës: Do të thotë një kontroll i pastërtisë së figurës apo një kontroll i regjistrimeve për identitetin e një personi, duke përfshirë çdo histori kriminale, si pjesë e vlerësimit të përshtatshmërisë së individit për hyrjen e pashoqëruar në zonat e kufizuara të sigurisë.

- Kontrolli standard i pastërtisë nënkupton atë kontroll të së kaluar i cili përsëritet çdo 3-vjet, dhe i nënshtrohen personat që kanë akses në zonat e kufizuara të sigurisë, dhe që nuk janë punonjës të sigurisë.
- Kontrolli i rreptë i pastërtisë nënkupton kontrollin e së kaluarës i cili përsëritet çdo vit, dhe i nënshtrohen personeli i sigurisë dhe çdo punonjës tjetër në këtë fushë.

Certifikimi: Një vlerësim zyrtar dhe konfirmim nga ose në emër të Autoritetit të Aviacionit Civil që tregon se personi ka përfunduar me sukses trajnimin aktual dhe se zotëron kompetencat e nevojshme për kryerjen e funksioneve që i janë caktuar në një nivel të pranueshëm.

0.6 Shkurtime

Në këtë manual udhëzues do të përdoren shkurtime e mëposhtme, të cilat do të nënkuptojnë:

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë
CBT	Trajnim i Bazuar ne Kompjuter
DAS	Drejtoria e Sigurisë në Aviacion
DE	Drejtor Ekzekutiv
EDS	Sistemi i Zbulimit të Eksplozivëve
OJT	Trajnimi në punë (on job training)
PKSAC	Programi Kombëtar i Sigurisë në Aviacionin Civil
PKTSAC	Programi Kombëtar i Trajnimeve të Sigurisë në Aviacionin Civil
SEPO	Spektori i Mbikëqyrjes së Personelit dhe Pajisjeve
OSHLA	Ofruesi i Shërbimit të Lundrimit Ajror

1. OBJEKTIVAT DHE ZBATUESHMËRIA

1.1 Qëllimi

Ky manual udhëzues vendos kriteret për certifikimin dhe ricertifikimin e punonjësve të sigurisë të cilët operojnë në fushën e sigurisë së Aviacionit Civil Shqiptar. Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë si dhe Programi Kombëtar i Trajnimeve e ngarkon AAC-në, që të garantojë se i gjithë personeli i punësuar i sigurisë kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kryer me efikasitet dhe vigjilencë të gjitha funksionet e ngarkuara në përputhje me detyrat si personel sigurie (në aeroport, OSHLA, kompanitë ajrore ose në agjentët e rregullt).

Objekt i këtij manuali udhëzues janë të gjitha subjektet që janë të përfshira në punësim, trajnim apo certifikim të personelit të sigurisë. Ky manual udhëzues aplikohet edhe në rastet e ricertifikimit periodik të personelit të sigurisë.

1.2 Baza Ligjore

Ky manual udhëzues është hartuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.411 datë 19.06.2024, "Për Miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil", Pjesa 4, Kapitulli 11, Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.1, datë 11.01.2023 "Për Miratimin e Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacionin Civil", Kapitulli 2, si dhe me Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Nr.163, datë 26.03.2021 "Për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil, Kapitulli 11.

2. POLITIKAT DHE PROCEDURAT

a) Punonjësit aktual- i gjithë personeli i sigurisë duhet të jetë i certifikuar sipas hierarkisë që mban dhe çdo punonjës i cili dështon kryerjen me sukses të trajnimeve përkatëse nuk duhet lejuar të ushtrojë detyrat e tij/saj si punonjës sigurie. Punonjësi që ka dështuar për herë të parë në kryerjen me sukses të trajnimit duhet t'i jepet mundësia për ritrajnim. Nëse punonjësi dështon për herë të dytë në kryerjen me sukses të trajnimit duhet t'i hiqet e drejta për të operuar si punonjës sigurie. Ky material udhëzues aplikohet në të gjitha rastet.

b) Punonjësit e testuar gjatë punës- i gjithë personeli që ka dështuar në testin gjatë punës ose i njohur ndryshe si 'drill' duhet të riestohet brenda një intervali shumë të shkurtër që nuk kalon 24 orë nga testimi fillestar. Nëse punonjësi i sigurisë dështon përsëri në identifikimin ose kalimin me sukses të testit duhet menjëherë të largohet nga operimi dhe t'i nënshtrohet trajnimit të rifreskimit. Nëse ndodh që i njëjti person ka të njëjtat dështime në të ardhmen, atëherë duhet të merren masa për largimin e tij/saj nga puna.

c) Revokimi- Dështimi në një nga elementët e ricertifikimit në një afat kohor të arsyeshëm që normalisht nuk i kalon 3 muaj, duhet të përmbillet me tërheqjen e certifikimit.

Në rastet kur kompetencat nuk janë ushtruar për më shumë se 6 (gjashtë) muaj, personeli i sigurisë duhet të marrë trajnim të përsëritur para se të lejohet të kthehet në detyrat e sigurisë.

Kur AAC, sipas evidencave (p.sh rezultate të përsëritura të trajnimit ose rezultate të testeve të fshehta të hapura dhe të mbyllura), është i sigurt që performanca e nevojshme e një punonjësi të certifikuar nuk

është arritur më, certifikimi duhet të tërhiqet dhe punonjësi nuk duhet të jetë në gjendje të shërbejë në atë funksion pune deri sa certifikimi mund të rivendoset.

d) Punonjësit e ri punësuar– personeli i sigurisë i ri-punësuar duhet t'i nënshtrohet dhe të kryej me sukses trajnimin bazik për pozicionin përkatës si dhe t'i nënshtrohet procesit të certifikimit fillestar.

e) Ri-certifikimi i punonjësve të sigurisë- duhet të kryhet sipas përcaktimeve në Urdhrin e Ministrit Nr.1, datë 11.01.2023, "Për Miratimin e Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacionin Civil".

f) Aplikimi për ri-certifikim- subjekti i përfshirë në punësimin e personelit të sigurisë duhet të aplikojë për ri-certifikim të punonjësve të sigurisë 1 muaj para se t'i mbaroj afati i përcaktuar në certifikatën e aplikantit. Nëse nuk arrihet ri-certifikimi i aplikantit si punonjës sigurie brenda afatit 3 muaj nga datat e aplikimit për ri-certifikim, punonjësit të sigurisë i tërhiqet e drejta për të ushtruar detyrat e tij/saj si punonjës sigurie.

g) Funksionet- punonjësi i sigurisë nuk mund të ushtroj detyra të tjera përveç atyre të përcaktuara në Certifikatën e lëshuar nga AAC në përputhje me pozicionin e punës.

h) Humbja e të Drejtës së Certifikatës- punonjësi i sigurisë e humbet të drejtën për të ushtruar detyrat e tij në rastet kur ai i jep një personi tjetër certifikatën e tij, ose gjendet duke ushtruar funksione të tjera nga ato që përcaktohen në certifikatë si dhe në rastet e parashikuara në pikën 4, gërma (b), (c) dhe (d) të këtij manuali udhëzues.

i) Shkelja apo mos respektimi i këtij manuali udhëzues- dështimi në respektimin e këtij manuali udhëzues përbën shkelje administrative.

3. TRAJNIMI

Trajnimi i personelit të sigurisë në fushën e sigurisë së aviacionit civil duhet të bëhet sipas Urdhrit Nr.1, datë 11.01.2023 "Për Miratimin e Programit Kombëtar të Trajnimit të Sigurisë në Aviacionin Civil".

4. KËRKESAT PËR CERTIFIKIM TË PUNONJËSVE TË SIGURISË

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet si punonjës sigurie, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar dhe të firmosur;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet;
- d) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- e) Certifikatën dhe pikët e testimit praktik;
- f) Dëshmi penaliteti;
- g) Kalimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- h) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- i) Trajnimin OJT (on job training)
- j) 2 fotografi.

4.1 Operator Skaneri

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet në pozicionin Operator Skaneri, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet;
- d) Kalimin me sukses të testit kompjuterik (CBT) nën mbikëqyrjen e instruktorëve të AAC-s;
- e) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- f) Syllabus të trajnimit bazik;
- g) Certifikatën dhe pikët e testit praktik;
- h) OJT (On job Training të paktën 14 ditë);
- i) Dëshmi penaliteti;
- j) Kalimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- k) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- l) Diplomë arsimit të mesëm (minimalisht);
- m) 2 fotografi;
- n) Të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze.

4.2 Supervizor Operator Skaneri

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet në pozicionin Supervizor Operator Skaneri, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet;
- d) Kalimin me sukses të testit kompjuterik (CBT) nën mbikëqyrjen e instruktorëve të AAC-s;
- e) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- f) Syllabus të trajnimit bazik;
- g) OJT (On job Training);
- h) Dëshmi penaliteti;
- i) Kalimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- j) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- k) Diplomë arsimit të lartë (minimalisht Bachelor);
- l) Eksperiencë si operator skaneri minimalisht 2 vjet;
- m) 2 fotografi;

- o) Të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze;
- p) Duhet të ketë njohuritë e mëposhtme:
 - njohuri e rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë së aviacionit;
 - njohuri të gjerë dhe eksperiencë në operimin e sigurisë së aviacionit;
 - njohuri në fushat e tjera të sigurisë, si: policia, ushtria, etj.;
 - njohuri minimale në fushat në vazhdim: sistemet e sigurisë dhe kontrollit të hyrje-daljeve; sigurinë në tokë dhe në fluturim (të avionit); armët dhe sendet e ndaluara; njohuri mbi terrorizmin.
- q) Performancat dhe vërejtjet gjatë punës duhet të reflektohen dhe të merren në konsideratë në procesin e ngritjes në detyrë të stafit të sigurisë;

4.3 Ruajtje & Patrullë (G & P)

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet në pozicionin agjent i ruajtjes dhe patrullimit, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet;
- d) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- e) Syllabus të trajnimit bazik;
- f) Certifikatën dhe pikët e testimit praktik;
- g) OJT (On job Training, minimalisht 14 ditë);
- h) Dëshmi penaliteti;
- i) Kalimin me sukses të kontrollit të pastërtisë së figurës;
- j) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- k) Arsim të mesëm (minimalisht);
- l) 2 fotografi;
- m) Të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze (e preferueshme).

4.4 Supervizor Ruajtje & Patrullë (G&P)

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet në pozicionin Supervizor Shërbim Patrulle, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet;
- d) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- e) Syllabus të trajnimit bazik;

- f) OJT (On job Training);
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Kalimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- i) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- j) Arsim të mesëm (e detyrueshme) dhe ose të lartë (e preferueshme);
- k) Eksperiencë minimale 2 vjet si agjent ruajtje & patrullë;
- l) 2 fotografi;
- m) Të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze (e preferueshme);
- n) Duhet të ketë njohuritë e mëposhtme:
 - njohuri e rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë së aviacionit;
 - njohuri të gjerë dhe eksperiencë në operimin e sigurisë së aviacionit;
 - njohuri në fushat e tjera të sigurisë, si: policia, ushtria, etj.;
 - njohuri minimale në fushat në vazhdim: sistemet e sigurisë dhe kontrollit të hyrje-daljeve; sigurinë në tokë dhe në fluturim (të avionit); armët dhe sendet e ndaluara; njohuri mbi terrorizmin.
- o) Performancat dhe vërejtjet gjatë punës duhet të reflektohen dhe të merren në konsideratë në procesin e ngritjes në detyrë të stafit të sigurisë.

4.5 Menaxher Sigurie (Operacional)

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet në pozicionin Menaxher Sigurie (operacional), operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse të analizuar;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për pozicionin që dëshiron të punësohet;
- d) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- e) Syllabus të trajnimit bazik;
- f) OJT (On job Training);
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Kalimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- i) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- j) Arsim i lartë;
- k) Eksperiencë në operim jo më pak se 5 vjet dhe si supervizor jo më pak se 2 vjet;
- l) Performancat dhe vërejtjet gjatë punës duhet të reflektohen dhe të merren në konsideratë në procesin e ngritjes në detyrë të stafit të sigurisë;
- m) 2 fotografi;
- n) Të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze;

- o) Duhet të ketë njohuritë e mëposhtme:
 - sistemet e sigurisë dhe akses kontroll;
 - siguria në tokë dhe gjatë fluturimit;
 - artikujt e kufizuar dhe të ndaluar;
 - njohuri të përgjithshme mbi terrorizmin dhe kërcënimet aktuale kundër Aviacionit Civil; dhe
 - të kuptuarit e rrezikut bazuar në qasjen e sigurisë.

Certifikimi konsiston në një testim me shkrim dhe/ose një intervistë me gojë, sipas gjykimit të AAC, i cili duhet të përmbajë një nga elementët e mëposhtëm:

- Një pyetësor me shumë alternativa;
- Një ese ose një rast studimi; ose
- Çdo lloj forme tjetër testimi e aprovuar nga AAC.

Në rastin e testimit, provimi me shkrim do të fokusohet në veçanti në njohjen dhe kuptimin e sigurisë së aviacionit, rregulloreve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare dhe përmbajtja e PKSAC.

Testi i certifikimit mund të bëhet nën supervizimin e AAC.

4.6 Menaxher Sigurie (Drejtues)

Në mënyrë që një aplikant të certifikohet në pozicionin Menaxher Sigurie-Drejtues, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për Menaxher Sigurie në Aviacion;
- d) Testin e provimit bazik, për Menaxher Sigurie në Aviacion, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- e) Syllabus të trajnimit bazik;
- f) OJT (On job Training);
- g) Dëshmi penaliteti;
- h) Kalimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- i) Formularin e aplikimit që përmban informacion në lidhje me CV, referencat e punëve paraprake, informacion për punësimin dhe justifikimin e hapësirave kohore bosh (nëse ka) gjatë 5 viteve të fundit;
- j) Eksperiencë në fushën e sigurisë së aviacionit civil, jo më pak se 5 (pesë) vjet; ose
- k) Eksperienca të tjera të sigurisë që lidhen me këtë fushë si fusha e zbatimit të ligjit, ose të tjera;
- l) Arsim i lartë;
- m) Njohje e detyrueshme e gjuhës Angleze, (Dëshmi të gjuhës Angleze);
- n) 2 fotografi;
- o) Duhet të ketë njohuritë e mëposhtme:
 - kontrollin e sistemeve të sigurisë dhe kontrollit të hyrjes;
 - siguria në tokë ose në fluturim;
 - armët dhe mjetet e ndaluara;
 - njohuri të përgjithshme mbi terrorizmin.

Certifikimi konsiston në një testim me shkrim dhe/ose një intervistë me gojë, sipas gjykimit të AAC, i cili duhet të përmbajë një nga elementët e mëposhtëm:

- Një pyetësor me shumë alternativa;
- Një ese ose një rast studimi; ose
- Çdo lloj forme tjetër testimi e aprovuar nga AAC.

Në rastin e testimit, provimi me shkrim do të fokusohet në veçanti në njohjen dhe kuptimin e sigurisë së aviacionit, rregulloreve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare dhe përmbajtja e PKSAC.

Testi i certifikimit mund të bëhet nën supervizionin e AAC.

4.7 Instruktor i Sigurisë

Personat që zhvillojnë dhe drejojnë trajnimin e sigurisë së aviacionit duhet të kenë certifikimin, njohuritë dhe përvojën e duhur e cila si minimum duhet të përfshijë:

- a) Certifikatë trajnimi bazik për instruktor të sigurisë (kualifikim që të instruktojë nga një institut i njohur arsimimi ose trajnimi ose organizatë ndërkombëtare e njohur nga AAC);
- b) njohje e mirë dhe përvojë e gjatë në operimet e sigurisë së aviacionit për të paktën 5 vjet;
- c) njohuri në fushat e mëposhtme:
 - rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë së aviacionit;
 - kontrollin e sistemeve të sigurisë dhe kontrollit të hyrjes;
 - sigurinë në tokë dhe në fluturim;
 - skanimin përpara hipjes në bord;
 - sigurinë e bagazhit dhe dërgesave;
 - sigurinë dhe kontrollet e avionit;
 - armët dhe sendet e ndaluara;
 - procedurat e emergjencës;
 - njohuri të përgjithshme mbi terrorizmin; dhe
 - fusha dhe masa të tjera që lidhen me sigurinë që konsiderohen të përshtatshme për ngritjen e ndërgjegjësimit të sigurisë;
 - kompetencë në teknikat e instruksioneve;
 - njohuri mbi mjedisin e punës në fushën aktuale të sigurisë së aviacionit;
 - kompetencë në mësimdhënien e elementeve të sigurisë.

Instruktorët që do të miratohen për dhënien e moduleve të operatorëve të skanerit dhe patrullës kërkohet specifikisht përvojë e mëparshme operationale si operator skanerit, për të siguruar nivelin e nevojshëm të ekspertizës dhe aftësive praktike në përdorimin e teknologjive të skanimit, të cilat mund të jenë të nevojshme edhe për operimin e patrullës dhe kontrollet fizike.

"Instruktorët e sigurisë i nënshtrohen një trajnimi fillestar të detyrueshëm për instruktor, i cili zhvillohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil ose nga një palë e tretë e autorizuar prej tij. Ky trajnim ka kohëzgjatje 5 (pesë) ditë dhe përfundon me një vlerësim përfundimtar me notë kaluese minimale 80%."

"Pas përfundimit të trajnimit fillestar, kandidatët për instruktorë i nënshtrohen një faze trajnimi praktik (On-the-Job Training), gjatë së cilës veprojnë si ndihmës instruktorë nën mbikëqyrjen e instruktorëve të certifikuar nga AAC."

"Gjatë kësaj faze, kandidatët duhet të përgatisin dhe prezantojnë module trajnimi për kategoritë përkatëse të personelit të sigurisë."

Trajnimi rifreskues për instruktorët e sigurisë kryhet të paktën një herë në 5 (pesë) vjet."

"Instruktorët e sigurisë duhet t'i nënshtrohen trajnimeve të përditësimit në fushën e sigurisë së aviacionit dhe zhvillimeve më të fundit të sigurisë të paktën çdo 2 (dy) vjet."

Të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- b) Certifikatën mjekësore nga mjeku i fushës përkatëse;
- c) Certifikatën e trajnimit bazik për Instruktor i Sigurisë në Aviacion;
- d) Testin e provimit bazik, nota minimale kaluese të jetë 80%;
- e) Syllabus të trajnimit bazik;
- f) OJT (On job Training);
- g) Përfundimin me sukses të kontrollit të rreptë të pastërtisë së figurës;
- h) Dëshmi të Gjuhës Angleze;
- i) Diplomën e arsimit të lartë;
- j) 2 fotografi;
- k) CV.

Certifikimi konsiston në elementët e mëposhtëm:

- Një pyetësor me shumë alternativa;
 - zhvillim dhe prezantim të moduleve trajnuese;
 - Një ese ose një rast studimi; ose
- Çdo lloj forme tjetër testimi e aprovuar nga AAC.

Provimi me shkrim do të fokusohet në veçanti në njohjen dhe kuptimin e sigurisë së aviacionit, rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përmbajtjen e PKSAC.

Testi praktik do të vlerësojë kapacitetin e kandidatit në rolin e instruktorit dhe aftësitë e tij/saj për të dhënë një modul të caktuar trajnimi.

Testi i certifikimit mund të bëhet nën supervizionin e AAC. Nota minimale kaluese është 80%.

5. KËRKESAT PËR RI-CERTIFIKIM TË PERSONELIT TË SIGURISË

Në mënyrë që një aplikant të ricertifikohet si punonjës sigurie, operatori i cili e ka punësuar duhet të dërgojë pranë AAC-s, shkresën zyrtare për ri-certifikim dhe dokumentet si më poshtë:

- a) Certifikatën e trajnimit periodik për pozicionin që mban;
- b) Rezultatet e trajnimit kompjuterik-CBT (për operatorët e skanerit);
- c) Rezultatet e trajnimeve periodike dhe kompjuterike;
- d) Syllabus të trajnimit periodik;
- e) Vlerësimet e bëra nga supervizorët apo menaxherët;
- f) Rezultatet e testimeve/drilleve të bëra gjatë kryerjes së detyrave;
- g) Të gjitha vërejtjet apo promovimet të bëra nga eprorët;
- h) Dëshminë e penalitetit.

Trajnimi dhe Ricertifikimi periodik

- ✓ Operatorët e Skanerit, trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhet çdo 2 vjet.
- ✓ Shërbim Patrulle trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhet çdo 3 vjet.
- ✓ Supervizorët Operator Skaneri, trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhet çdo 2 vjet.
- ✓ Supervizorët Shërbim Patrulle, trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhet çdo 3 vjet.
- ✓ Menaxherët e Sigurisë (operacional), trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhet çdo 3 vjet.
- ✓ Drejtuesit e Sigurisë, trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhen çdo 3 vjet.
- ✓ Instruktorët e Sigurisë në Aviacion, trajnimi dhe ricertifikimi periodik kryhet çdo 5 vjet.

6. VLERËSIMI

Drejtorja e Sigurisë në Aviacion është përgjegjëse për vlerësimin e dosjeve të personelit të sigurisë. Nëse punonjësit e Sektorit të Mbikëqyrjes së Personelit dhe Pajisjeve, konstatojnë se dosjet e sjella për certifikim/ricertifikim janë të plota me dokumentacionin e kërkuar në këtë manual udhëzues, plotësohet certifikata nga Specialisti i SEPO, kalon për aprovim pranë Përgjegjësit të Sektorit të Mbikëqyrjes së Personelit dhe Pajisjeve dhe më pas kalon për firmë pranë Drejtorit të DAS dhe Drejtorit Ekzekutiv.

Format e certifikatave gjenden bashkëlidhur këtij manuali udhëzues.

Nëse punonjësit e Sektorit të Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit dhe Pajisjeve, konstatojnë se dosjet e sjella për ricertifikim janë të plota me dokumentacionin e kërkuar në këtë manual udhëzues, përditësohet certifikata nga Specialisti i SEPO me afatet e reja, aprovohet nga Përgjegjësi i Sektorit SEPO dhe kalon për firmë pranë Drejtorit të DAS.

Nëse punonjësit e Sektorit të Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit dhe Pajisjeve, konstatojnë se dosjet e sjella për certifikim dhe ricertifikim, nuk janë në përputhje me këtë manual udhëzues, kanë të drejtë t'i refuzojnë certifikimin apo ricertifikimin çdo aplikanti.

Punonjësi humbet të drejtën për të ushtruar detyrat e tij në rastet kur ai i jep një personi tjetër certifikatën e tij, ose gjendet duke ushtruar funksione të tjera nga ato që përcaktohen në certifikatë si dhe në rastet e parashikuara në pikën 4, gërma (b), (c) dhe (d) të këtij manuali udhëzues.



Dështimi për të ndërmarr dhe për të plotësuar me sukses ricertifikimin në një afat kohor të arsyeshëm që normalisht nuk i kalon 3 muaj, duhet të shoqërohet me tërheqjen e certifikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION

Nr. Prot.

Tiranë, më / /2026

CERTIFIKATË

INSTRUKTOR I SIGURISË NË AVIACIONIN CIVIL

Në mbështetje të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil (PKSAC) miratuar me VKM Nr. 411, datë 19.06.2024, kapitulli 11, pika 11.5, Programit Kombëtar të Trajnimeve të Sigurisë në Aviacionin Civil (PKTSAC) miratuar me Urdhrin Nr.1, datë 11.01.2023, pika 2.8, si dhe Urdhrit të Ministrit Nr.163 datë 26.03.2021 “Për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standarteve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, pika 11.5;

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë miraton si Instruktor të Sigurisë në Aviacion:

Znj / Z

Lindur më datë;

Në cilësinë e Instruktorit të Sigurisë në Aviacionin Civil MBAJTËSI ka të drejtën të ofrojë kurse trajnimi të sigurisë, për kategoritë e personelit të përmendura në Aneksin 1 të kësaj certifikate.

Aneksi 1 është pjesë e pandarë e kësaj Certifikate.

Drejtör Ekzekutiv

Maksim Et’hemaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY
DIRECTORATE OF AVIATION SECURITY

No. Prot.

Tirana, on / / 2026

CERTIFICATE
OF AVIATION SECURITY INSTRUCTOR

Pursuant to the National Civil Aviation Security Programme (NCASP) approved by Albanian Government Decision No. 411, date 19.06.2024, chapter 11, point 11.5, to the National Civil Aviation Security Training Programme (NCASP) approved Order No. 1 date 11.01.2023, points 2.8 and to the Minister Order No.163 date, 26.03.2021 "On determining detailed measures for the implementation of basic common standards in the field of civil aviation security", point 11.5;

Albanian Civil Aviation Authority approves as Aviation Security Instructor:

Mrs / Mr

Born on date;

In the capacity of a civil aviation security instructor, the holder is entitled to provide security training courses for the categories mentioned in Annex 1 of this certificate.

Annex 1 is an integral part of this Certificate.

Executive Director

Maksim Et'hemaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E SIGURISË NË AVIACION

ANEKS 1

PËR

CERTIFIKATËN E INSTRUKTORIT TË
SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL

Nr. Prot.

Tiranë, më / / 2026

INSTRUKTOR: Znj. / Z

Kursi i miratuar	Përmbajtja e kursit (moduli/modulet sipas Kapitullit 5 të PKTSAC)	Kategoritë e personelit të cilëve u adresohet kursi (sipas Kapitullit 5 të PKTSAC)
Trajnime për Sigurinë	Moduli	Të gjitha kategoritë e personelit që kanë mundësi hyrje në zonat e kufizuara të sigurisë
.....		

*Shënim: Nëse AAC nuk është më i kënaqur me performancën e instruktorit të sigurisë gjatë kryerjes së trajnimeve dhe nëse ai nuk përmbush kompetencat përkatëse, AAC ka të drejtë të revokojë certifikatën.

Drejtör Ekzekutiv

Maksim Et'hemaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
CIVIL AVIATION AUTHORITY
DIRECTORATE OF AVIATION SECURITY

ANNEX 1
OF
THE CERTIFICATE
OF AVIATION SECURITY INSTRUCTOR

No. Prot.

Tirana, on / / 2026

INSTRUCTOR: Mr / Mrs.

Course approved	Content of course (module/modules Ref. Chapter 5 of NCASTP)	Categories of personnel to whom the course is (Ref. Chapter 5 of NCASTP)
Security Trainings	Module	All categories of personnel that have access to enter to the secured restricted areas
.....		

*Note: Where the ACAA is no longer satisfied that training delivered by a qualified instructor is resulting in the relevant competencies, the ACAA shall revoke the certificate.

Executive Director

Maksim Et'hemaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIC OF ALBANIA

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
CIVIL AVIATION AUTHORITY



DIREKTORIA E SIGURISË NË AVIACION
DIRECTORY OF AVIATION SECURITY

CERTHIKATË
PERSONELI SIGURISË SË SHQIPËRISË
AIRORE

CERTIFICATE
AIRLINE SECURITY STAFF

Testuar në përputhje me Kushtetimin e KSHL PR/ISAC, Ambion 17
to PR/AS dhe DOK. 30 të KSHAC

Issued in compliance with the Albanian Air Code, PR/ISAC, Art. 17
Annex 17, and ICAO Doc 30

26583

FORMA E CERTIFIKATËS SË PERSONELIT TË SIGURISË NË AVIACION

SHITETI LESHUES SHQIPËRIA STATE OF ISSUE ALBANIA	
Nri Certifikatës: Certificate No:	
Emri/ Adhienti: Name/ Surname:	
Data dhe Vendi i Lindjes: Date and Place of Birth:	
Adresa e Plotë: Full Address:	
Shërbimi: Citizenship:	
Nënshkrimi i mbledhësit: Signature of Holder:	
Operator:	
Amenduar nënshkrimi nga: Authorized signed by:	Vula: Stamp:



FORMA E CERTIFIKATËS SË PERSONELIT TË SIGURISË NË AVIACION

Kushtet dhe Afund/Terms and Conditions:

*Certifikata duhet të ketë fotografi në mbyqësi dhe hollësi të tjera.
Certificate should bear the holder's photograph and other details.*

*Mbyqësi i kësaj Certificate është i vetmi person që mund të kryejë detyrat e sigurisë së aviacionit sipas postit të shënuar në këtë dokument.
The Holder of this Certificate is the only person who is allowed to conduct security duties according to the definition of the post held as specified in this document.*

Pas pajisjes me këtë Certificate, mbyqësi detyrohet të zbatojë në çdo moment dispozitat, rregulloret, praktikat dhe procedurat siç përmbahen në kërkesat kombëtare të sigurisë së aviacionit civil dhe detyrimet ndërkombëtare në përputhje me ICAO Anexin 17 – Siguria, legjislacionin për Aviacionin Civil Shqipëri, dhe ECAC Dok. 30 – Pjesa II Siguria (I kufizuar).

*Immediately after being granted this Certificate, the Holder **MUST**, at all times, abide with and enforce all the provisions, regulations, practices and procedures as contained at national civil aviation security requirements and international obligations in compliance with ICAO Annex 17 - Security, national legislation of civil aviation and ECAC Doc. 30, Part II Security (Restricted).*

Ky dokument është në pronësi të Autoritetit të Aviacionit Civil Shqipëri dhe në momentin që mbyqësi nuk është më tej agjent sigurie ose certifikata konsiderohet e pavlefshme, duhet të rikthehet menjëherë në zotërin të AAC.

This document is property of the Albanian Civil Aviation Authority and at the moment the holder is no longer a security agent, or the certificate is considered as invalid, it should be returned immediately to the AAC.

XXXXXX